



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 76

Prishtinë, më 22 prill 2013, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S 2

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi, Behar Selimi, Mufera Şinik, Ardian Gjini, Haki Demolli, Halit Krasniqi, Gëzim Kelmendi, Arsim Bajrami, Albulena Haxhiu, Armend Zemaj dhe Jasmina Zhivković.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Xhevat Azemi – AKP, Visar Smajlaj - Ekspert, Lejla Selimi – OSBE, Besnik Ramadani – KDI/TIK.

Nga Stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Arben Gashi , kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 18.03.2013;
3. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të pronës, për vitin 2012;
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin Nr. 04/L-179 për transportin rrugor;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari propozoi në pikën të ndryshme të futet kërkesa nga organizata “Çohu” , të cilën e keni bashkëngjitur në materiale.

Albulena Haxhiu – Tha se në mbledhjen e kaluar u tha se pas diskutimit të raportit të AKP-së do të diskutohet edhe projektligji për Agjencinë Kosovare për krahasim dhe verifikim të pronës, mirëpo unë nuk po e shoh në rend dite. Propozoi të futet në rend dite.

Behar Selimi – Ishte i mendimit që në këtë mbledhje duhet të shqyrtohet vetëm raporti i AKP-së, kurse mbledhjen e radhës diskutojmë për këtë Projektligj me konkretisht.

Rendi i ditës u miratua me ndryshimet e propozuara nga kryetari Komisionit. Propozimi i deputetes Albulena Haxhiut nuk u përkrah nga Komisioni.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 18.03.2013

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 18.03.2013, me vërejtjet e paraqitura nga Armend Zemaj që në diskutimin e tij kërkoi pas fjalës “publike” shtohen fjalët “gjatë viteve 1990-1999” si dhe shkurtesa “AKP” zëvendësohet me “AKM”.

3. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Pronës, për vitin 2012

Xhevat Azemi – Në fjalën e tij para deputetëve paraqiti raportin e punës së Agjencisë për vitin 2012. Ai tha se kjo agjenci vazhdoi me aktivitete e veta për përmbushjen e mandatit që e ka me ligj. Ka përfunduar 25 kërkesa pronësore, lidhur me pronën e paluajtshme, pronën private, administrimin e pronave, si dhe zbatimin e skemës së qirasë. Aktivitete e para në përpunimin e çdo kërkesë që janë publikim i kërkesave dhe verifikimi i dokumentacionit, identifikimi i pronave thuajse janë përfunduar, janë disa që kanë mbetur si rezultat i vështirësive në gjetjen e dokumentacionit për ato prona. Numri i përgjithshëm në këtë agjenci është 42. 347 kërkesa. Prej këtij numri gjatë vitit 2012, janë gjykuar 11.220 kërkesa shumica prej tyre prona bujqësore, ndërsa një pjesë e vogël për prona banesore dhe prona komerciale. Në fund të vitit 2012 duke përfshirë edhe kërkesat e vendosura gjatë atij viti numri i përgjithshëm i kërkesave të vendosura janë 35.734 kërkesa, nëse e bëjmë një krahasim në ditët e sotme ky numër është 37.415. Paralelisht me vendosjen e kërkesave është punuar në zbatimin e vendimeve të marra nga komisioni për kërkesat pronësore. Gjatë vitit 2012 janë shpërndarë 14.845 vendime parashtruesve të kërkesave dhe 640 vendime të palës përgjegjëse, që numri i përgjithshëm është 15.485 vendime. Pjesa më e madhe e parashtruesve të kërkesave kanë kërkuar zbatimin e vendimit përmes lënies së pronës nën administrim që është rreth 60% të parashtruesve të kërkesave. Parashtruesit e suksesshëm të kërkesave kanë kërkuar që vendimi i tyre të zbatohet përmes administrimit të pronave. Numri i vendimeve të zbatuara në vitin 2012 ka qenë 7. 977 vendime. Për vendime të shpërndara gjatë vitit 2012 kemi marrë 162 ankesa, që ju kanë bërë Gjykatës Supreme dhe ky numër i vogël i ankesave, në krahasim me numrin e lëndëve të vendosura tregon për një kualitet dhe për një numër shumë të vogël pjesëmarrësish në procedurë të cilët kanë shprehur pakënaqësi me vendimin e shkallës së dytë në Gjykatën Supreme. Deri në fund të vitit 2012 janë pranuar 425 ankesa, ndërsa deri sot janë pranuar 498 ankesa për 34. 000 vendime të shpërndara. Pas zbatimit të vendimeve pason faza e mbylljes së kërkesave, gjatë vitit 2012 janë mbyllur 4790 gjithsejtë. Mund të them se ka përfunduar komplet procedura, ndërsa tani ky numër është 14,032, kjo është sa i përket mandatit kryesor, apo vendosjes së kërkesave pronësore. Si mandat tjetër i administrimit të pronave gjatë vitit 2012 agjencia ka marrë nën administrim 3505 prona të reja që bashkë me pronat që kanë qenë nën administrim para vitit

2012 numri i përgjithshëm i pronave nën administrim të agjencisë në fund të vitit ka qenë 8.186 tani ky numër është 9546, që do të thotë numri i pronave nën administrimin e agjencisë po rritet në mënyrë rapide në krahasim me vendosjen e kërkesave. Nga numri i përgjithshëm që janë nën administrim të agjencisë për 3. 119 pronarët kanë kërkuar që të kryejnë skemën e qirasë dhe prej tyre në fund të vitit 2012 kanë qenë të nënshkruara marrëveshjet e qirasë për 958 prona, kryesisht prona banesore. Ka filluar zbatimi i skemës së qirasë edhe për pronat bujqësore gjë që është në pajtim edhe me politikat e Kosovës për shfrytëzimin e tokave bujqësore. Ky numër nuk është shumë i madh i tokave bujqësore të dhëna me qira. Nga skema e qirasë gjatë vitit 2012 janë mbledhur 612.000 €, prej të cilave 531.000 € ju kanë paguar pronareve, kurse pjesa tjetër janë në një fond mirëbesimi për pronat që statusi pronësor nuk është i destinuar. Deri në fund të vitit 2012 kanë qenë të mbledhura 3. 732. 000 €, prej të cilave 2. 859, 000 iu kanë paguar pronareve, kjo shifër deri në ditët e sotme është rritur dhe është rreth 4. 000, 000 €. Faza tjetër në procedurën e zbatimit të mandatit të vet është dëbimet. Zbatimi i vendimeve apo dëbimeve për shkak të mos pagesës së qirasë gjatë vitit 2012 kanë qenë të caktuara 2. 617 dëbime që është një numër jashtëzakonisht i madh. Shumica prej tyre kanë qenë shkak i mos pagesës së qirasë, mirëpo një pjesë e tyre ka të bëjë me dëbimet për riposedit të pronave, Prej 2. 617 dëbimeve të caktuara 832 janë zbatuar me dëbim fizik, kurse pjesa tjetër janë anuluar për arsye se shfrytëzuesit aktual të pronave e kanë paguar qiranë, apo e kanë liruar pronën para ditës së dëbimit. Edhe vitin 2012 e karakterizon ajo çka kam raportuar vitin e kaluar pamundësia e dëbimeve në pjesën veriore të Kosovës edhe pse agjencia ka ndërmarrë të gjitha veprimet, i ka caktuar dëbimet, e ka dërguar edhe ekipin në Mitrovicë. Mirëpo prapë nuk kemi pasur mbështetje nga organet e rendit edhe për kundër një bashkëpunimi që e kemi me policinë për pjesët e tjera të Kosovës. Një dukuri apo sfidë tjetër që na ka vështirësuar punën në pjesën e dëbimeve është edhe riuzurpimi ose uzurpimet pas dëbimit, për pengimin e kësaj dukurie kemi pasur kontakte të shumta edhe me prokurorinë edhe me policinë, sepse kemi tentuar që riuzurpimi apo dëbimi i vulës zyrtare kur bëhet dëbimi paraqet vepër penale sipas kodit penal të Kosovës. Me qëllim të parandalimit të kësaj dukurie është mirë të merren hapa konkret. Në 141 raste të riuzurpimeve gjatë vitit 2012 është iniciuar procedura penale në prokurori, ndërsa deri në fund të vitit 2012 ka qenë e iniciuare lënda në 323 raste. Agjencia i ka 158 pozita të stafit vendor ka edhe një pjesë të pozitave të ndërkombëtarëve, financimi i pagave për 72 pozita bëhet vetëm prej buxhetit të Kosovës, ndërsa për 186 pozita bëhet edhe prej buxhetit të Kosovës, edhe prej donacionit. Sa i përket buxhetit javën e kaluar kemi raportuar në Komisionin për buxhet dhe raporti i jonë është aprovuar. Ai foli edhe për buxhetin e agjencisë, si dhe ndryshimet ligjore që janë bërë me ligjin për përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare që ka të bëjë me bartjen e kompetencave nga zyra ndërkombëtare e Kuvendit.

Kryetari pyeti, sa është shuma totale gjatë viteve të ekzistencës, sa janë investuar dhe ku ruhen ato para, nga kush menaxhohen? Sa lëndë kanë mbetur të pa përfshira për mbylljen e misionit të Agjencisë?

Armend Zemaj – Ai kishte vlerësim pozitiv për punën e Agjencisë dhe stafit në përgjithësi, duke marrë parasysh specifikat e punës sa i përket çështjeve në kontestet pronësore. Ky vlerësim pozitiv tregon se deri me tani është një nder institucionet e rralla që nuk ka afëra korruptive. Duke marrë parasysh që ne, për çdo vit, përcjellim raportimin e kësaj agjencie, unë e shoh si sukses të stafit aty. Pyeti se sa keni mundur ju të zbatoni aktgjykimet finale të Gjykatës Supreme dhe si ka rrjedhur çështja e riuzurpimeve. Agjencia në fund të vitit 2013 është paraparë të jetë

vendore, a mund të na paraqitni ju një vizion se si do të bëhet kjo, dhe si e shihni ju marrjen e këtyre përgjegjësive të plota, sepse nga tabelat e paraqitura shihet qartë se ka shumë konteste të pazgjidhura në tërë Republikën e Kosovës, veçanërisht pjesa veriore?

Albulena Haxhiu – Kishte vërejtje në raportin e paraqitur duke shtuar se si subjekt politik edhe këtë vit do të votojmë kundër këtij raporti. Njëri ndër elementet kryesore të pavarësimit të një vendi sigurisht se është edhe procesi i dekolonizimit, pra e drejta e një populli që t'i kthehet prona. Nëse nuk kthehet kjo pronë nga pushtuesi, po nuk ju krijuan kushtet që ai ta këtë mundësin e zhvillimit ekonomik, ai sigurisht do të përfundojë i varur, që do të thotë se pa pronë ai prapë do të bëhet i varur. Agjencia e pronës e bën të kundërtën dhe në bashkëveprim me Agjencinë Kosovare të Privatizimit e bëjnë shpronësimin e plotë Kosovës duke injoruar faktin që Kosova ka qenë nën pushtim. Pronat në Agjencinë Kosovare të Pronës nuk shikohen në prizëm të një trajtimi të thellë dhe të drejtë, ndërsa kur bëhet fjala për pronat e shqiptareve në Veriun e Kosovës ato trajtohen vetëm sipërfaqësisht me arsyetimin e situatës atje. Është një numër tejet i vogël i trajtimit të pronave atje ku lindin problemet edhe përkundër kërkesave të shqiptareve, duhet ta përmendim faktin që janë 11.564 shqiptarë të dëbuar nga veriu i Mitrovicës, pronat e të cilëve i shfrytëzojnë serbet atje. Veriu i Mitrovicës para vitit 2000, e edhe në vitet e më hershme ishte i banuar me shumicë shqiptare, çështja e pronave në veri zvarritet dhe çështja e serbeve është privilegj. Prioritet i juaji janë pronat e serbëve, që realisht janë të shqiptareve, po që janë uzurpuar nga serbët pa u shikuar asnjëherë origjina e atyre pronave. Në Kosovë kanë ndodhur shkatërime, dëbime, rrëmbime pronash edhe kjo me dekada. Shqiptaret e mbajnë mend me se tepërmi blerjen dhe riblerjen e pronës se vet dhe kjo është një padrejtësi e madhe që po ju bëhet shqiptarëve. Me Agjencinë Kosovare të Pronës dhe me këtë politikë të pa drejt nuk ka ndërtim të shtetit të Kosovës, nuk ka zhvillim dhe do të këtë çdo here varësi. Çështja e pronave duhet shikuar duke pasur parasysh dekolonizimin, origjinën e pronave pasi ajo do të duhej të ishte e shenjtë për të gjithë, pa dallim. Pra AKP - ja e bën pikërisht të kundërtën duke cenuar të drejtat e qytetareve tanë, dhe nuk do të parashtroj pyetje, se e di që nuk do të marrë përgjigjen e duhur.

Arsim Bajrami – Në fjalën e tij tha se kemi pasur raportime korrekte nga kjo Agjenci e cila ka pasur një mision të caktuar dhe ka pasur mbështetje të fuqishme ndërkombëtare. Ne kur e kemi përgatit Ligjin për përfundimin e Pavarësisë se mbikëqyrur kemi diskutuar shumë qartë në Komisionin Kushtetues. Pyeti se a është duke u përgatitur menaxhmenti vendor për marrjen e plotë të përgjegjësive me rastin e kalimit të afatit, kur përfundon mandati i ndërkombëtar dhe a kemi kapacitet të mjaftueshme, kur mendoni ta konsideroni të mbyllur misionin e kësaj Agjencie, sepse kjo është Agjenci e përkohshme nuk është e përhershme. Çështja e Veriut është një e metë që përcjell efikasitetin e punës së Agjencisë, ju thatë se keni pasur probleme me implementimin dhe e lëvduat policinë e Kosovës në këtë pjesën tjetër, por a keni raporte të mira me policinë e EULEX-it që edhe atje të jetë funksionale dhe të zbatohen ato vendime, suksesi është gjysmak se atje nuk keni bërë asgjë, sepse atje ka uzurpime masive të pronave të shqiptareve.

Halit Krasniqi – Tha se pajtohet me parafolësit lidhur me punën e këtij stafi të këtij institucioni, por edhe raportet që i kanë vendosur në Komisionin për Legjislacion. Do të doja të dija nëse ka të dhëna se sa banorë të Mitrovicës janë zhvendosur nga pronat e tyre këndeje Ibrit, sepse përdora një shifër, por nuk isha i sigurt në atë shifër, megjithatë përafërsisht mendoja se duhet të jetë ashtu.

Haki Demolli – Falënderoi drejtorin e Agjencisë për një raportim të thuktë. Tha se ky raport tregon që ka pasur një punë mjaft të madhe, përkundër vështirësive që hasnit në punët e përditshme, por edhe në punët zyrtare në Kosovë. Vërtet është fascinuuese ku një numër i madh vendimesh janë marrë vetëm 162 ankesa, që do të thotë se vendimet që janë marrë nga ana e Agjencisë janë vendime të drejta. Mirëpo ajo që u përmend mjaft shumë është çështja e Mitrovicës të dëbuar nga veriu dhe vështirësitë që i ka Agjencia me zbatimin e vendimeve të cilat i merr vet. Më intereson a keni ndonjë plan apo strategji me të cilën ishin përfshirë subjektet apo institucionet me relevante të Kosovës, sepse tek e fundit prona është e shenjtë?

Jasmina Zhivković –Në diskutimin e saj shtoi se përkthimi i këtij Raporti është shumë i mirë dhe i qartë. Ajo në vazhdim pyeti pse në organet mbikëqyrëse nuk ka të punësuar serb? Në vazhdim tha se përmendët mosrespektimin e vendimeve në veri, por mendoj se edhe në pjesët e tjera ka moszbatim të vendimeve dhe kërkoi sqarim se cilat janë rekomandimet e juaja që këto vendime të respektohen ?

Ardian Gjini – Duke u ndërlidhur me diskutimet e parafolësve tha se as drejtori i Agjencisë, as zëvendësdrejtori nuk vendos se a duhet të ekzistoj Agjencia, sepse vendos tjetër kush. Vlerësoi se nuk është kthimi mënyrë e vetme pune e kësaj agjencie. Pyetje e adresuara nga anëtarët e Komisionit i vlerësoi si të rëndësishme dhe korrekte edhe njëkohësisht falënderoi drejtorin për prezantimin e raportit, si në respektimin e afatit kohor, ashtu edhe në përmbajtjen e tij.

Gëzim Kelmendi – Tha se vjen nga Peja dhe pyeti se a do të ishte më mirë që të punohej si në Pejë, ashtu edhe në pjesën Veriore të Mitrovicës?

Pyetjeve të anëtarëve të Komisionit ju përgjigj drejtori Agjencisë dhe pas debatit, Komisioni për Legjislacion me “ një “ votë kundër nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Të shqyrtohet dhe të miratohet Raporti i punës së Agjencisë Kosovare të Pronës për vitin 2012.

4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin Nr. 04/L-179 për transportin rrugor

Kryetari paraqiti vërejtje në amendamentin 43, fjalët “**Dhe, për motoçikleta një plus një (1+1) ulëse por vetëm brenda qytetit**”, nuk ka bazë për procedim të mëtejshëm dhe është në kundërshtim me nenin 2, të Projektligjit dhe nenin 57.4, të Rregullores së Kuvendit.

Armend Zemaj – Paraqiti vërejtje në amendamentin 5, sipas tij ky amendament është në kundërshtim me ligjin e konkurrencës.

Kryetari – Propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e radhës pas u ngritën dilema për amendamentet 5 dhe 43.

5. Të ndryshme

a. Kërkesa e Organizatës “Çohu”

Kryetari – I njoftoi anëtarët me kërkesën e Organizata “Çohu” ku thuhet se kërkojnë nga Komisioni për Legjislacion që të na japë përgjigje lidhur me deklarin e pasurisë së zyrtarëve për vitet 2010, 2011, 2012 dhe 2013. Problemi është te vakumi ligjor në kemi kërkuar që ata t'i sjellin formularët e deklarimit për vitin 2011, por për vitin 2012 nuk kemi kërkuar. Drejtori i Agjencisë kundër korrupsionit do të paraqesë raportin e punës për vitin 2012.

Edhe pse kërkesa e parashtruar, si e tillë për qasje në dokumentet zyrtare, nuk është kërkesë sepse nuk po kërkohen dokumente konkrete, por janë parashtruar pyetje që më shumë ka formën e një ankete.

Armend Zemaj – Propozoi që të ftohet organizata “Çohu” kur do të shqyrtohet raporti i AKK-së për vitin 2012 dhe paralelisht do të trajtohej edhe kjo pyetje.

Mbledhja përfundoi në orën 13:20

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetari i Komisionit

Arben Gashi